

VENDIM
Nr.523, datë 30.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.243, DATË 26.3.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE
INSTITUCIONET BUXHETORE PËR VITIN 2004 DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH
BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.243, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen 1 “Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2004” të bëhen këto ndryshime:

a) Numri i punonjësve buxhetorë për Ministrinë e Shëndetësisë, për periudhën 1 maj-31 dhjetor 2004 ndryshon dhe bëhet “21 339”.

b) Numri i punonjësve buxhetorë për Ministrinë e Mbrojtjes ndryshon dhe bëhet “8 911”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 maj 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano